

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"LG Construction"**

Sot me date 02/05/2023 (dymije e njezet e tre), une, Bardhyl Latka, ortak i vetem i shoqerise **LG Construction** shpk, ne perputhje te plote ne Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregraret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, dhe legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, hartoj kete Statut te shoqerise, si vijon:

**KREU I**

**Data e themelimit, Emertimi, Objekti, Kohezgjatja, Zyra Qendrore, Forma e shoqerise, Vula e Shoqerise**

**Neni 1**

**Data e themelimit, Emertimi, dhe Themeluesit**

Shoqeria " **LG Construction** " SHPK, krijohet ne date 02.05.2022 nga ortaku si me poshte: **Bardhyl Latka** i biri i Ramadan, lindur me 28.02.1963, ne Korce dhe banues ne Korce, Rruga "28 Nentori", Nderresa 79 Hyrja 1, me shtetesi shiptare, mbajtes i letemjofimit me numer personal G30228253V, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ne baze te aktit te themelimit te dates 02 Maj 2023.

**Neni2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria eshte person juridik shqiptar.

Shoqeria gezon te drejta si person juridik shqiptar, qe prej dates ne te cilen kryhet regjistrimi i saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statut ).

**Neni3**

**Forma e shoqerise**


Shoqeria do te kete formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, derisa me vendim te Asamblese se Pergjithshme te vendoset shnderrimi i formes ligjore.

**Neni4**

**Objekti**

Shoqeria " **LG Construction** " SHPK, dote kete si objekt te veprimtarise:

- a) Nderim dhe Projektim te objekteve te ndryshme Godina Banimi, Industriale, Bujqesore etj, punimeve te ndertimit, rikonstruksione;
- b) Mbikeqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi dhe montimi ne godina civile, industriale, bujqesore, turistike, shoqerore, veprave hidroteknike, sisteme te fumizimit me uje, kanalizime te ndryshme, rruge, ura dhe vepra arti, punime komunale dhe te mjedisit, si dhe punime te te gjitha llojeve ne fushen e ndertimit dhe montimit.
- c) Projektimi, ndertimi dhe mirembajtja e sistemeve inxhinierike te ujerave dhe impianteve te ujerave te objekteve sportive, interiere, peisazhi, siperfaqe te gjelbra, lulishte e parqe.
- d) Konsulence inxhinierike ne te gjitha fushat e inxhinierise strukturale, hidroteknike, etj.





e) Veprimtari e lidhur me asistencen teknike dhe asistencen inxhinierike te te gjitha sherbimeve te permendura me siper, etj.

#### Neni 5

##### Kohezgjatja

Shoqeria " **LG Construction** " SHPK, kryen veprimtarine e saj tregtare per nje periudhe kohore te pacaktuar derisa te vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme.

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe nga kjo date ajo mund te filloje te ushtroje aktivitetin tregtar deri kur me vendim te Asamblesese Pergjithshme te vendoset prishja e shoqerise ose kur shoqeria mbaron ne nje nga menytrat e parashikuara ne ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

#### Neni 6

##### Selia

Selia kryesore e shoqerise dote jete ne Rruga 28 Nentori , Lagjja 6, Pazari i Bicikletave Z.Kadastrale 8564 Nr Pasurie 6/760, Korce. Me vendim te Administratorit selia e shoqerise mund te ndryshohet, mund te hapen dege, dhe zyra perfaqesimi te saj brenda dhe jashte Shqiperise

#### Neni 7

##### Vula e Shoqerise

Shoqeria do te kete vulen e saj duke shenuar ne te emertimin tregtar, iniciale, ose Nipt.

### KREUII

#### Kapitali

#### Neni 8

##### Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100.000 (Njeqind mije) leke, i zoteruar nga ortaku si me poshte:

Emri, Mbiemri	% qe zoteron	Kuotat qe zoteron
Bardhyl Latka	100 %	1 kuote


Ky kapital eshte i ndare ne 1 (nje) kuote le zoteruar 100 % , nga ortaku i vetem sipas tabelës me siper.

Ortaku themelues **Bardhyl Latka**, zoteron 1 kuote, me vlere te pergjithshme 100 000 leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar do te depozitohet ne nje Banke ne Shqiperi me nje llogari te hapur ne emer te shoqerise ne formim e siper ose ne arken e shoqerise.

#### Neni 9

##### Kuotat dhe te drejtat e lidhura me to





Çdo kuote i jep te drejten e nje vote per te miratuar vendime sipas ligjit nr. 9901 , date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare". Te gjitha kuotat do te ushtrohen nga ortaket sipas zoterimeve.

#### Neni 10

##### **Kuotat, Fitimi dhe Transferimi i tyre**

Kuotat e kapitalit te shoqeri mund te fitohen nepermjet kontributit ne kapitalin e shoqerise shitblerjes, trashegimise, dhurimit, apo çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

### **KREUIII**

#### **Asambleja e Pergjithshme**

##### **Neni 11**

##### **Asambleja e Pergjithshme. Thirrja e mbledhjes. Marrja e vendimeve. E drejta e votes.**

Asambleja e Pergjithshme, si organ kryesor i shoqerise sipas ligjit "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" perfaqesohet ne kete shoqeri nga ortaket.

Asambleja e Pergjithshme thirret me shkrese jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes, ne adresat e percaktuara ne dispoziten "Njoftimet" me poshte. Njoftimi duhet te permbaje ditën, oren dhe vendin ku do te mbahet mbledhja si dhe rendin e dites. Njoftimi behet nga Administratori i shoqerise apo nga çdo ortak i cili perfaqeson te pakten 5 (pese perqind) te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit per te vendosur per 9eshtje te tilla si miratimi i bilancit dhe pasqyrave financiare, miratimi i raportit te auditimit te shoqerise. Mbledhjet mbahen ne seline shoqerise, apo edhe ne nje vend tjeter te njohur nga ortaku i vetem. Vendimet merren nga Asambleia e Pergjithshme.


##### **Neni 12**

##### **Kompetencat e Asamblese**

Asambleja e Pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine ne lidhje me 9eshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimin e Statutit
- c) Emerimin/ shkarkimin e Adnistratorit, eksperteve kontabel, likujdatoreve;
- d) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Adnistratoret pershire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- g) kryerjen e kontroll - revizionit financiar te shoqerise me eksperte te caktuar prej saj;
- h) Te vendose per zmadhimin dhe vogelimin e kapitalit
- i) Te vendose per riorganizirni dhe prishjen e shoqerise;
- j) (eshtje te tjera q .iane te rendesishme per aktivitetin tregtru. te shoqerise.

##### **Neni 13**





### Perfaqesimi ne Asamble

Ortaku mund te perfaqesohet ne mbledhje, ne rastet kur e ka te pamundur pJesemarrjen personalisht ne mbledhje nga nje person i trete ose edhe nga nje ortak tjetër shoqërie. Autorizimi duhet te kete te percaktuar qarte kompetencat e perfaqesuesit si dhe te drejtat e tij lidhur me vendimantjen nembledhje.

### KREUIV

#### Administratori

#### Neni 14

#### Administrimi i shoqërise

Shoqëria administrohet nga nje Administratori i gjedhur nga Asambleja Pergjithshme. Administrator i shoqërise dote jeteZ. Bardhyl Latka i biri i Ramadan, lindur me 28.02.1963, ne Korce dhe banues ne Korce, Rruga "28 Nentori", Ndertesa 79 Hyrja I, me shtetesi shiptare, mbajtes i letemjofimit me numer personal G30228253V, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.


Afati i ushtrimit te detyres eshte 5 (pese) vjet mete drejte ripertitje.

#### Neni 15

#### Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit. Pergjegjesite

Administratori ushtron kompetencat e meposhtme:

- a) Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqërise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- b) Vepron me te tretet ne emer dhe per llogari te shoqërise brenda kompetencave te parashikuara ne statut apo dhe ne ligjin "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare";
- c) Kryen emerimin dhe shkarkimin nga puna te punemanesve te shoqërise;
- d) Jepurdhra dhe udhezime punemarresve dhe vendos sanksione ndaj tyre, ne perputhje me kontratat e punes dhe rregulloret e brendshme te shoqërise;
- e) Drejton dhe organizon punen ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqërise ne veprimtarine e saj ekonomiko - financiare;
- f) Raporton para Asamblese se Pergjithshme sa here qe Asambleja e kerkon si dhe ne rastet kur eshte i nevojshem raportimi ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posa9me me rendesi te ve9ante per veprimtarine e shoqërise tregtare;
- g) Zbaton vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme;
- h) Paraqet ne menyre te rregullt dhe ne kohe te pershtatshme te Asambleja e Pergjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogarite vjetore, si dhe te pergjigjet per to;
- i) Ushtron te drejta dhe detyrime te tjera te percaktuara nga ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare";





## Neni 16

### Mbarimi i mandatit te Administratorit

Mandati i Administratorit perfundon:

- a) me mbarimin e afatit, dhe nuk eshte bere riemerimi;
- b) me shkarkimin e tij nga Asambleja e Pergjithshme;
- c) kur vete Administrator jep doreheqjen vullnetarisht;
- d) sipas menyrave te tjera para hikuar nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

## KREUV

### Viti Financiar. Prishja e Shoqerise .Dispozitat e fundit

## Neni 17

### Viti Financiar

Veprimet financiare mbyllen me 31 dhjetor te (çdo viti. Administratori merr masa lidhur me nxjenjen e bilancit te hartuar konform ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

## Neni18

### Mbarimi i Shoqerise

Shoqeria " **LG Construction** " SHPK, mbaron:

- a) Me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- b) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- c) Sipas shkaqeve te tjera te parashikuara nga ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

## Neni 19

### Njoftimet

Njoftimi per ortakun duhet te kryhet sipas adreses se percaktuar ne Nenin 6 te ketij Statuti. Ortaku eshte i detyrmar te njoftoje ndryshimet ne adresen e tij

## Neni 20

### Te ndryshme

Per (i:eshtje qe nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, gjejne referim ne dispozitat e ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Shoqeria " **LG Construction** " SHPK regjistrohet sipas parashikimeve te bera ne ligjin Ligji 131/2015 date 26.11.2015 "per qendren kombetare te biznesit"

Statuti u hartua ne 3 ( tre ) kopje ne gjuhen shqipe me vlere te njejte juridike

## ORTAKU I SHOQERISE

Bardhyl LATKA

